

RAPORT

Mbi detyrat e realizuara për vitin 2010

Në mbështetje të planit të punës për vitin 2010, ku janë të përcaktuara detyrat kryesore dhe objektivat bazë, Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet ka realizuar me përpikmëri detyrat e ngarkuara për këtë vit. Gjithashtu gjatë këtij viti është punuar dhe jashtë planit të punës, në bazë të problematikës që ka dalë në ZMR. Me poshtë po paraqesim disa nga detyrat e realizuara gjatë këtij viti, në lidhje me drejtimet bazë të punës tonë sic janë inspektimi, licensimi, import eksportet, transportet si dhe problematikën me të cilën jemi ndeshur gjatë këtij viti

-INSPEKTIMI

Bazuar në planin vjetor për vitin 2010, prioritet gjatë kësaj periudhe për këtë zyrë ka qënë realizimi i inspektimeve në rang prefekturë, duke i dhënë prioritet qyteteve dhe prefekturave, të cilat nuk u realizuan gjatë 2009 si dhe inspektim subjektesh, të cilave u ka kaluar afati i licensës, duke mbajtur qëndrim ligjor, sic e përcakton rregullorja e sanksioneve.

Në bazë të planit të inspektimeve për vitin 2010 janë kryer inspektime në kabinetet e radiologjisë shtetërore dhe private që kanë në përdorim gjeneratorë me rreze X si dhe në ato qendra ku aplikohet me burime të hapura dhe të mbyllura radioaktive. Duhet theksuar se për arsye objektive nuk janë realizuar një pjesë e inspektimeve në rrethe sipas planit vjetor sidomos në gjashtë mujin e dytë, të cilat mendojmë që duhet të kenë prioritet gjatë vitit të ardhshëm.


Inspektimet e realizuara për këtë periudhe po i paraqesim si më poshtë vijon:

Subjekte Shtetërore:

1. Qendra e Fizikës Bërthamore të Zbatuar
2. Spitali Ushtarak,
3. Poliklinika nr.1 Tiranë,
4. Poliklinika Paskuqan,
5. QSUT,
6. Spitali Rajonal dhe Poliklinikë Elbasan,
7. Spitali Rajonal Librazhd,
8. Spitali Rajonal Gramsh,
9. Qendra Shëndetësore Fushë-Krujë,
10. Spitali Rajonal Krujë,
11. Spitali Rajonal dhe Dispanceri Lac,
12. Spitali Rajonal dhe Poliklinikë Berat,
13. Spitali Rajonal Lushnjë,
14. Spitali Rajonal Fier,
15. Spitali Rajonal Vlorë.
16. Spitali i ri Kavajë

Subjekte Private:

1. Poliklinika Pro-Life,
2. Hygeia Hospital,
3. Kamza Medical
4. Fushe –Kruje Cement Factory
5. Qendra “Medicare” Berat,
6. Blue Medical Center,
7. Galenus,
8. Birra Malto,
9. Erton Diagnostic Center
10. Tealk-Alb,
11. Ëestern Atlas International,
12. QSHNG
13. TEA,sh.p.k
14. Laboratori Domi
15. Nasto Inxhiniering
16. Demiraqi



Grafik 1

Në grafikun 1 është paraqitur nr i inspektimeve të kryera në subjektet private dhe shtetërore gjatë vitit 2010. Nga grafiku vihet re një nr i barabartë inspektimesh në subjekte shtetërore dhe ato private.

-LICENSIMI

Në zbatim të ligjit Nr.8025 datë 09/11/1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, i ndryshuar si dhe rregullores mbi “Licensimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues” Nr.10 datë 07/01/2010, procesi i licensimit ka vazhduar normalisht dhe gjatë këtij ,që nga e faza e parë që është njoftimi e deri në fazën e fundit që është miratimi ose jo i licensës.

Janë miratuar nga KMR 33 licensa,nga të cilat 13 janë licensa te reja, 20 janë rinovim license, ndërsa 2 subjekte kanë amenduar licensën pasi kanë zgjeruar aktivitetin e tyre duke shtuar pajisje me burime të rrezatimit jonizues ose kanë bërë rikonstrukcion të ambjentit dhe 1 licensë është revokuar nga KMR për arsye se ndërtimi i këtij kabineti nuk ishte në përputhje me vendimin e Ministrisë së Shëndetësisë nr.547 datë 14.10.2008.

Licensat e miratuara nga KMR për këtë vit janë si më poshtë vijon:

- 1-“Tirana International Airport”,Tiranë (9 skanera të sigurisë)
- 2-Shoqëria “Iris”,Tiranë (import-eksport aparatura mjekësore me rreze X)
- 3-Klinika Radiologjike“Profiti”Durrës (Panoramex,grafi dentare,grafi dhe mamografi)
- 4-Klinika Radiologjike“Enesi”,Durrës(grafi/skopi)
- 5-Klinika Dentare Radiologjike“Huta”,Durrës (Grafii dentare,panoramex)
- 6-Klinika Radiologjike “Medison”,Tiranë (Grafii,panoramex)
- 7-Kurum International,Elbasan(4 burime radioaktive Co-60)
- 8-Birra Tirana,Tiranë (1 burim i mbyllur radioaktiv Am-241)
- 9-Ekokem –Palvelu,Vlorë (Am-241Be dhe Cs-137)
- 10-Klinika Dentare Radiologjike “Monda”,Tiranë (Panoramex)
- 11-MC.Dr.Shiroka,Durrës(Grafii,Coronarografi,CT-Skaner)
- 12-Kabineti i Radiologjisë “Suta”,Elbasan(Grafii dhe Panoramex)
- 13“Tealk-Alb”,Tiranë(CT-Skaner)
- 14-Klinika “Zonja e Këshillit të Mirë”,Tiranë (Grafii, Mamografi,Panoramex dhe 2 Grafii dentare të lëvizshme)
- 15-Laboratori Bio-Kimik-Hormonal “Domi”,Tiranë(Ekzaminime RIA)
- 16-Poliklinika “Pro-Life”,Tiranë (Mamografi)
- 17-Departamenti i Prodhimit Bimor,Universiteti Bujqësor,Tiranë (Gas-Chromatographs,Ni-63)
- 18-“Kamza Medical”,Tiranë (Grafii/Skopi)
- 19-Western Atlas International,Fier (Cs-137, 2 burime Am241Be,Ra-226)
- 20-“Universal German Hospital”,Tiranë(Burime të mbyllura radioaktive Co-57 dheCs-137 për kalibrim ,si dhe burime të hapura radioaktive të cilat do të përdoren në departamentin e mjekësisë bërthamore)
- 21-“Hygeia Hospital Tirana”,Tiranë(Gjeneratorë me rreze X,Radioterapi,Mjekësi Bërthamore)
- 22-“T.E.A”sh.p.k,Tiranë (Am-241)
- 23-“Galenus”,Tiranë (CT-Skaner)
- 24-Klinika “Ikeda”, Tiranë (grafii, CT- skaner, Litotript)
- 25-Klinika Orthodokse, Tiranë (grafii/skopi, mamografi, CT- skaner)
- 26-Qendra Shendetësore nr. 1, Tiranë (grafii/skopi)
- 27-Klinika “Amavita”, Tiranë (grafii)
- 28-Klinika “Mirdita Dental”, Tirane (grafii dentare, panoramex)
- 29-Blue Medical Center,Tiranë(grafii,panoramex,mamografi)
- 30.Erton Diagnostic Center,Tiranë(grafii,mamografi)
- 31.Fushë-Krujë Cement Factory(Cf-252)
- 32.Nasto Inxhiniering,Vlorë (Ir-192 dhe grafii industriale me rreze X)
- 33.Klinika Radiologjike Jon,Elbasan(grafii/skopi)
- 34.Klinika dentare “Arjon”(grafii dentare)


35. Amendim i licensës “Zonja e Këshillit të Mirë” (grafi, mamografi, grafi dentare dhe panoramex)

Për të gjithë këto subjekte është krijuar një dosje e vecantë dhe është bërë vlerësimi përkatës nga inspektori sipas formatit të përshtatur dhe unifikuar nga ZMR.


Në grafikun e mëposhtëm është bërë një shpërndarje e burimeve të rrezatimit jonizues sipas aparaturave me rreze X, burimeve radioaktive të mbyllura dhe të hapura, të cilat përdoren nga subjekte të ndryshme në fushën e mjekësisë, industrisë apo edukimit dhe shkencës.

Nr i burimeve të rrezatimit jonizues të licensuara gjatë këtij viti											
Lloji	CT	Mamo	Grafi+ litotript	Gr/dent dhe panor.	GR/Sk	Skanera të sigurisë	Coronarografi	Akselerat	Burime rad të mbyllura	Burime rad të hapura	C-Arm
nr	5	6	8	6+7	5	9	1	2	17+grafi industriale me rreze X	3	1

Më poshtë kemi paraqitur me grafik nr e burimeve të rrezatimit jonizues të licensuara gjatë vitit 2010.



Grafik 2



Grafik 3

Në grafikun 3 kemi paraqitur nr e licensave të miratuara gjatë vitit 2010 e krahasuar me nr e licensave të miratuara gjatë vitit 2009.

-IMPORT-EKSPORTI

Procesi i import –eksporteve të materialeve radioaktive ka funksionuar mbështetur në VKM për import-eksportet në Republikën e Shqipërisë, Nr.158 datë 13/02/2008,udhëzuesin mbi import-eksportet e materialeve radioaktive Nr.4756/1,datë21/12/2006 dhe rregulloren për “Import-eksportin dhe tranzitin e burimeve radioaktive”,Nr3918/4,datë 3/11/2004.


Gjatë këtij viti janë dhënë 77 aprovime import-eksporti,një prej të cilave nuk është ekzekutuar për arsye teknike të subjektit.Gjatë këtij viti janë kryer kryesisht importe dhe eksporte të burimeve radioaktive të mbyllura, të përfshira në grupin e sigurimit C , është importuar një burim i mbyllur radioaktiv i Kat II,grupi i sigurimit B,burime të hapura radioaktive të cilat kryesisht përdoren për ekzaminime “in Vitro” dhe “in Vivo”, si dhe gjeneratorë me rreze X.Gjithashtu gjatë këtij viti janë eksportuar 4 burime Ir-192, sipas kontratave të nënshkruara për kthimin e burimeve radioaktive tek prodhuesi në fund të jetës së tij.Kthimi i burimit tek prodhuesi në fund të përdorimit ka qënë një nga strategjitë e punës tonë në mënyrë që të krijohen sa më pak mbetje në vend.

Më poshtë po paraqesim shpërndarjen e importeve dhe eksporteve të kryera gjatë vitit 2010. Gjatë vitit 2010 vihet re një shtim të numrit të importeve dhe transporteve,si rezultat i shtimit të numrit të subjekteve të licensuar, të cilët përdorin burime të rrezatimit jonizues në mjekësi,industri apo kërkime shkencore.


Nr i aprovimeve mbi import-eksportet e burimeve të rrezatimit jonizues

Medicare	Kurum	Nasto Inxh.	Univers Alb	Neo Style	Domi	Hygeia Hospital	QSUT	Ekokem	Tea shpk
26	1	1 import 1 eksport	18	12	3	2 akseleratore linear 1burim i mbyllur 4 burime te hapura	2 importe 3 eksporte	1 Am241Be Cs137	1

Total:77 Aprovime import-eksport



Grafik 4



Grafik 5


Në grafikun 4 është paraqitur nr i import-eksporteve të aprovuara gjatë këtij viti,ndërsa në grafikun 5 është krahasuar nr i import-eksporteve të miratuara gjatë vitit 2010 me import-eksportet e kryera gjatë 2009.

-TRANSPORTI

Transporti në Republikën e Shqipërisë kryhet nga subjekte të licensuar nga KMR dhe që zbatojnë të gjitha dispozitat e rregullores për “Transportin e sigurtë të materialeve radioaktive”Nr.488 datë 23.06.2010,si dhe të gjitha dispozitat e tjera që lidhen me transportin.Këto kompani të licensuara janë Qendra e Fizikës Bërthamore të Zbatuar dhe Medicare

Në lidhje me aprovimet e lëshuara nga ZMR për transportin, gjatë kësaj periudhe janë dhënë 72 aprovime transporti për burime të hapura dhe të mbyllura,nga të cilat 61 janë transport për burime të hapura,të cilat përdoren për diagnostikim “in Vitro” dhe “In Vivo” si dhe kalibrimin e pajisjeve në mjekësinë bërthamore, nga katër subjektet kryesore Medicare,Univers-Alb, Neo Style dhe Hygeia Hospital dhe 10 janë leje transporti për burime të mbyllura,të cilat përdoren në fushën e mjekësisë dhe industrisë dhe 1 është aprovim transporti për burim radioaktiv të kategorisë II. Një nga këto leje nuk është ekzekutuar për arsye teknike të subjektit.

Në grafikun e mëposhtëm po paraqesim një shpërndarje të aprovimeve të dhëna për këtë vit.




Grafik 6

Nr.i aprovimeve për transportin	
Medicare,QFBZ, Burime të hapura	Qendra e Fizikës Bërthamore e Zbatuar, burime të mbyllura
61	11

Total: 72 aprovime transporti

Në grafën 7 është paraqitur me përqindje nr i aprovimeve për transport të dhëna për vitin 2010 të krahasuara me vitin 2009.



Grafik 7

-SANKSIONET

Megjithese struktura ligjore eshte e plote ne lidhje me sanksionet kjo nuk ka qene prioritet i ZMR. Ne kete kuader nuk jane marre masa ndeshkuese per subjektet ne shkelje te ligjit por eshte ndjekur politika per sqarimin dhe plotesimin e dokumentacionit ne lidhje me sigurine dhe sigurimin e burimeve te rrezatiit jonizues.

-INVENTARI

Inventari i burimeve eshte i plotesuar rane ZMR ne sitemin RAIS ku pervec inventarit te pajisjeve dhe burimeve jane perfshire dhe licencat dhe inspektime. Po punohet per plotesimin dhe me te dhenat e tjera. Nje problem mebtet mos instalimi i RAIS ne versionin SQL me qellim qe cdo inspektor te punoje ne hapsiren e tij virtuale dhe kontrolli te jete me efikas si strukture e plote e nje menaxhimi cilesor.

-MBLEDHJET E KMR-së

Gjatë këtij viti janë realizuar 4 mbledhje të KMR ku dhe janë marrë disa vendime.

Objektivi kryesor i KMR-së për këtë vit ka qenë përgatitja e draftit për rrezatimet jojonizuese. Për këtë qëllim u ngrit një grup pune, i cili pas diskutimeve të shumta doli me vendimin që KMR, si autoritet kompetent në fushën e rrezatimeve jonizuese, të mbulojë dhe problemet e rrezatimeve jojonizuese, gjithashtu në draft do të shtohen nene të vecanta ku të theksohet se monitorimi dhe vlerësimi i efekteve në shëndet të bëhet nga departamenti Shëndeti dhe Mjedisi, pranë Institutit të Shëndetit Publik. Për sa i takon vlerësimeve teknike do të realizohen nga grupe bashkëpunimi. Draft Ligji është përgatitur në 14 nene me objekt shëndetin e punonjësve të ekspozuar profesionalisht dhe popullatës.

KMR ka miratuar dokumentin mbi "Terminologjinë e përdorur dhe përcaktimet e termave në mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese, sigurinë dhe sigurimin e materialeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë", dokument i cili është përgatitur nga Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet me qëllim lehtësimin e punës së agjensive të ndryshme si dhe vetë Trupës Rregullatore.

KMR ka miratuar dokumentin për kategorinë e punonjësve A dhe B ku theksohet se:

Veprimtaritë ku përfshihet punonjës i ekspozuar i kategorisë A, i cili është e mundur të marrë një dozë efektive më të madhe se 6 mSv në vit, ose një dozë ekuivalente më të madhe se 3/10 e kufirit të dozës për lentet e syve ose ekstremitetet sipas limiteve të përcaktuara nga Trupa Rregullatore, do të mbulojnë me dozimetri personale.

Për veprimtaritë ku përfshihet punonjës i ekspozuar i kategorisë B (në kategorinë B përfshihen të gjithë ata punonjës që nuk përfshihen në kategorinë A) nuk do të mbulojnë me dozimetri personale.

Gjithashtu është punuar dhe në lidhje me Memorandumin e bashkëpunimit midis Drejtorisë së Sigurisë nga Rrezatimi të Republikës së Maqedonisë dhe Zyrës së

Mbrojtjes nga Rrezatimi të Republikës së Shqipërisë, e cila ka për qëllim shkëmbimin e informacioneve teknike dhe shkëmbimin e eksperiencave në fushën e rrezatimeve jonizuese.

Në kuadrin e bashkëpunimit me vendet fqinjë në lidhje me sigurimin dhe sigurinë për një punë të sigurtë Ministria e Shëndetësisë ka nxjerre një urdhër Nr.376 datë 19.06.2009, i cili ngarkon ZMR të fillojë negociatat me Trupën Rregullatore të vendeve fqinjë me qëllim nënshkrimin e marrëveshjeve të mirkuptimit në fushën e bashkëpunimit për import-eksportet, transportin e sigurtë të materialeve radioaktive, si dhe krijimin e urave lidhëse në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi.

Monitorimi i mjedisit ka qënë gjithashtu një objekt kryesor për KMR. Në lidhje me këtë pikë Qendra e Fizikës Bërthamore të Zbatuar ka përgatitur një draft në përputhje me Direktivën 35 të BE-së (Euratom Treaty), ku kërkohet se çdo shtet anëtar i BE duhet të krijojë strukturën dhe bazën e nevojshme materiale për të realizuar monitorimin e vazhdueshëm të niveleve të radioaktivitetit në ujë, tokë dhe ajër dhe të garantojë që këto nivele të jenë brenda normave të vendosura nga komiteti ndërkombëtar.

Gjatë të këtij viti janë miratuar nga Këshilli i Ministrave pesë rregullore si më poshtë:

1-Rregullore mbi "Licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues" Nr.10 datë 07.01.2010

2-Rregullore mbi "Kategorizimin e burimeve radioaktive" Nr.8 datë 07.01.2010

3-Rregullore mbi "Trajtimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive" Nr.7 datë 07.01.2010

4-Rregullore mbi "Transportin e sigurtë të materialeve radioaktive" Nr.488 datë 23.06.2010

5-Rregullore për "Punë të sigurtë me burime të rrezatimit jonizues" Nr.453 datë 07.07.2010.

KMR ka miratuar në parim dhe rregulloren mbi "Sigurimin Fizik të burimeve radioaktive", e cila është dërguar për mendim në ministritë e linjës dhe më pas do të kalohet për miratim në Këshill të Ministrave. Rregullorja është përshtatur me Direktivën e Europës 2003/122, datë 22/12/2003 mbi kontrollin e burimeve të mbyllura me aktivitet të lartë si dhe burimet jetimë.

KMR në mbledhjen e tij të fundit miratoi Kodin e Praktikës për përdoruesit në Mjekësinë Bërthamore ku janë bërë ndryshime mbi parimet e terapisë së pacientëve me I-131 si dhe mbrojtja nga rrezatimi në këtë lloj terapie.

Gjithashtu KMR ka miratuar Listën III mbi nivelet udhëzuese për dozën, fuqinë e dozës dhe aktivitetin për ekspozimet mjekësore, nivelet për daljen e pacientëve të trajtuar me I-131 nga spitali dhe nivelet e dozës për të cilat do të ndërmerren ndërhyrje në cfarëdo rrethane.

Për sa i takon konventave mbi "Sigurinë bërthamore" dhe Konventa e bashkuar për sigurinë dhe menaxhimin e lëndës djegëse të konsumuar dhe trajtimin e mbetjeve radioaktive janë miratuar në parim nga KMR, përkthimi është certifikuar nga Ministria e Drejtësisë dhe gjithashtu janë miratuar dhe nga Komisioni Parlamentar i Ligjeve, Komisioni i Sigurisë Kombëtare, Komisioni i Jashtëm, ndërsa në Komisionin e Shëndetësisë pati kundërshtime.

Një çështje tjetër ka qënë dhe pjesëmarrja në projektet rajonale për ciklin 2012-2013 në IAEA. Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet do të jetë si kundërpast i pesë

projekteve rajonale që kanë të bëjnë me ekspozimin e publikut, trupën rregullatore, ekspozimet profesionale, reduktimin e ekspozimit të radonit si dhe mbi sigurinë në transport, gjithashtu ZMR do të jetë si kundërpast i detyrë për realizimin e disa projekteve të tjera në bashkëpunim me institucione, si QSUT apo QFBZ.

KMR ka miratuar dokumentin model mbi përgatitjen e raportit të inspektimit nga inspektorët.

ZMR ka përgatitur dhe matricën ligjore për vitin 2011, gjatë të cilit do të realizohen:

- Ligji për "Mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese"

- VKM mbi "Përcaktimin e niveleve kufi për përqëndrimin e radonit në ndërtesa, radiobërthamave në ushqime dhe materialet e ndërtimit".

- VKM për "Mbrojtjen e punonjësve të ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimit jonizues"

- VKM mbi "Monitorimin e nivelit të radioaktivitetit në mjedis"

Problematika

Gjatë këtij viti zyra ka hasur dhe problematika të natyrave të ndryshme, të cilat kanë ndikuar sadopak dhe në realizimet e detyrave të kësaj zyrë.

Një shqetësim i ngritur prej kohësh nga ZMR ka qënë situata dhe licensimi i spitaleve shtetërore. Konkretisht gjatë vitit 2009 janë licensuar 6 spitale rajonale dhe poliklinika, por licensa nga këto subjekte nuk është tërhequr dhe pas njoftimit zyrtar të bërë nga ana jonë.

Një problematikë tjetër ka qënë plotësimi i dokumentacionit nga këto institucione, ku shume prej tyre e kanë nisur këtë proces, por nuk e kanë vazhduar më tej si rezultat i neglizhencës apo vështirësive për plotësimin e tyre dhe pse kane pasur mbeshtetje nga ana jone në cdo moment. Ministria e Shëndetësisë ka nxjerrë disa urdhëra, në mënyrë që të nxisin këto subjekte për vazhdimin e procesit për licensim, por që deri tani nuk kanë pasur rezultat.

Gjithashtu ZMR ka ngritur si shqetësim dhe problemin e ekspertëve. Në zbatim të vendimit të marrë në mbledhjen e KMR-së datë 11/12/2009, ku theksohet se do të njohë si ekspert të kualifikuar në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese vetëm ata që do të të kualifikohen pranë QFBZ. Ky vendim deri tani nuk është zbatuar dhe ZMR ka qënë e detyruar të pranojë ekspertiza nga persona që nuk njihen nga KMR.

Si rezultat i këtij shqetësimi të ngritur nga ZMR është ngritur një grup pune i cili ka bërë një përcaktim të kritereve dhe ka vendosur terma reference si: arsimimi, eksperienca në punë etj, për pranimin e ekspertëve, të cilat do të diskutohen në mbledhjet e ardhshme të KMR-së.

PKMZSA

Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet po punon dhe për përshtatjen e legjislacionit shqiptar që përfshin mbrojtjen nga rrezatimi jonizues me legjislacionin europian në

kuadër të integritit të Shqipërisë në Europë. Detyrimet që duhet të përmbushë Shqipëria reflektohen në Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKMZSA), që është instrumenti bazë i procesit të Integritit European. Ky dokument strategjik përfshin inisiativat ligjore dhe aktivitetet zbatuese të prioriteteve të adresuara nga Dokumenti i Partneritetit European (2007) dhe Raporti Vjetor i KE (2009).

Është punuar sipas metodologjisë së përditësimit të PKZMSA dhe me sistemin online ku janë pasqyruar objektivat e punës për periudhën 2010-2014. Gjatë 2010 ZMR ka punuar dhe raportuar për progres raportin në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet.

Njëkohësisht ZMR ka punuar në 5 projekte me BE dhe IAEA që përfshijnë trupën rregullatore, siguria dhe sigurimi i burimeve të mbyllura radioaktive, mbi NORM e TENORM, menaxhimi i mbetjeve radioaktive dhe monitorimi i radioaktivitetit në mjedis. Në kuadër të këtyre projekteve janë zhvilluar një sërë takimesh si brenda dhe jashtë vendit.

Lidhur me ndihmën me të huajt është përgatitur dhe project fiche për 2010. Projekti “ Hapa të mëtejshme për përafrimin e legjislacionit shqiptar dhe rregulloreve në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet dhe sigurinë e burimeve rrezatuese me *acquis Community*”.

PYETËSORI I KE

Ka përfunduar me sukses procesi për plotësimin e përgjigjeve të Pyetësit të Komisionit Evropian dhe hartimin e përgjigjeve. Janë përgatitur përgjigjet dhe janë zhvilluar edhe disa takime me grupet e punës për të plotësuar përgjigjet për kapitullin 15 “Energjia bërthamore” (Mbrojtja nga Rrezatimet), si dhe përgjigje për pyetje që lidhen me çështjet e rrezatimit dhe mbrojtjes nga rrezatimi në kapituj të tjerë të Pyetësit, sic janë Kapitulli 3, 28. Të gjitha përgjigjet janë raportuar në institucionet përkatëse dhe në mbledhjet e organizuara në METE.

BDTI

Shqipëria është përfshirë në sistemin e Bankës së të Dhënave për Trafikun Ilegal (BDTI) të lëndëve radioaktive pranë Agjensisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (IAEA). ZMR ka filluar punën dhe po punon aktualisht me mbledhjen e të dhënave dhe sistemimin e këtij lloj informacioni në bashkëpunim me Institucione të tjera shtetërore shqiptare dhe me Agjensinë. Ky informacion përshtatet në një format në përputhje me dokumentat e ANEA-s, ku përshkruhet natyra e incidentit si dhe ndarja në kategori e saj. Informacioni i marrë arkivohet pranë ZMR i kategorizuar sipas burimeve radioaktive.

SEMINARE, TAKIME DHE TRAJNIME

Është siguruar pjesëmarrja në seminare e takime të nivelit ndërkombëtar, sic mund të përmendim:

- Takimi për implementimin e Kodit të Drejtimit, 17-21 Maj 2010, në Viene, Austri IAEA

- Takimi i nënkomitetit i Transportit, Energjisë, Mjedisit dhe Zhvillimit Rajonal me përfaqësuesit e BE, 3 Qershor 2010, Bruksel
- Takimi në Paris, France për ngritjen e strukturave rregullatore për manaxhimin e mbetjeve radioactive, 7-9, Qershor 2010, IAEA
- Takimi koordinues i Programit IPA me Shumë-përfitues, me pjesëmarrës nga Komisioni Europian: Drejtoria e Përgjithshme e Zgjerimit dhe Delegacionet e BE në vendet e rajonit, Institucionet përgjegjëse të vendeve të rajonit dhe Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal. 29-30 Qershor 2010, Tiranë, Shqipëri.
- Workshop mbi "Edukimi dhe trajnimi si mjetet kryesore për zbatimin e ORP", 14-17 Shtator 2010, Larnaca, Qipro.
- Workshop i avancuar "Shkolla për hartimin e rregulloreve", 3-28 Maj 2010, Vienë, Austri